



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 16, datë 09.01.2020

PËR

REVOKIMIN E VENDIMIT NR.47, DATË 29.04.2015, TË ISH-KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “MBI PEZULLIMIN NGA DETYRA TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË, OSMAN ALIU”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 151, 156/2/b dhe 157 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 29 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të revokojë Vendimin nr. 47, datë 29.04.2015, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Osman Aliu”.
2. T’i njohë gjyqtarit Osman Aliu të drejtën për përfitimin e pagës për të gjithë kohën e pezullimit nga detyra, nga data 29.04.2015.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. Osman Aliu sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR